



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 16 gusht 2010), nenit 15, paragrafi 15.7, nënparagrafi (e) dhe nenit 22, paragrafi 22.7, nënparagrafi (e) të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2017, miratoi

Rregullore për Vlerën e Kontributeve të Pensionit

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregullore është të përcaktojë kriteret minimale për përcaktimin e vlerës që mund të kontribuohet për programin e Pensionit plotësues.
2. Kjo Rregullore aplikohet për Fondin Pensional Plotësues të Punëdhënësit ("Fond Pensional"), dhe përshtatshmërisht për Pensionet Plotësuese Individuale (Ofruesi i Pensionit).

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e përcaktuara në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (në vijim: Ligji për Fondet Pensionale) dhe/ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
 - 1.1. **Pension i shumave të caktuara** - nënkupton, një pension i cili llogaritet në bazë të një formule për të cilën punëdhënësi ose një pjesëmarrës individual ka marrë përsipër obligimin për të kontribuar në baza vjetore një shumë të caktuar në përputhje me aktet normative të fondit pensional ose me rregullat pensionale dhe vlerësimin aktuarial. Formula për një pension të caktuar mund të përcaktohet në bazë të shumës së rrogës mesatare të pjesëmarrësit dhe kohëzgjatjes së shërbimit të punëdhënësi, siç mund të përkufizohet më tej nga BQK-ja, ose të përcaktohet ndryshe me rregulloret mbi pensionet.

- 1.2. **Supozimet aktuariale** - nënkupton metodat e vlerësimeve financiare dhe demografike që janë përdorur për të llogaritur kontributet e nevojshme për të financuar përfitimet e pensionit të shumave të caktuara. Këto supozime ndër tjera përfshijnë: normat e interesit, rritjen ekonomike, normën e vdekshmërisë, normën e paaftësisë, norma e përfundimit të kontribuimit, norma e rritjes së pagës ose ndryshimet në kulturën e përgjithshme të kompensimit.
- 1.3. **Vlerësim aktuarial** - nënkupton raportin e një aktuari të pavarur i licencuar nga një organizatë shtetërore ose profesionale të një shteti që është anëtar i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim që tregon aktiven dhe detyrimet e shumave të një fondi të caktuar pensional.
- 1.4. **Fonde Plotësuese Pensionale** - nënkupton Fondin Pensional dhe Ofruesin e Pensioneve;
- 1.5. **Pagë** - nënkupton çfarëdo shume që punëdhënësi paguan në para ose në mall si kompensim për shërbimet e ofruara të punonjësit gjatë kohës së punësimit, në bazë të kontratës së punës, të formuluar ose të nënkuptuar, me gojë ose me shkrim. Paga përfshin rrogën, fitimin, shtesat, përqindjen ose ndonjë formë tjetër të pagesës lidhur me punësimin.
- 1.6. **Baza e fitimeve të pensionit** - nënkupton fitimet ose pjesën e fitimeve të pjesëmarrësit, shuma e të cilave mund të përcaktohet me aktet normative të Fondit Pensional, të shfrytëzuara si baza për llogaritjen e shumës së kontributeve të Pensionit dhe benefiteve.
- 1.7. **Të drejtat e fituara** - nënkupton të drejtat e pjesëmarrësit apo përfituesit në një pension plotësues të punëdhënësit ose në një pension plotësues individual që nuk mund të humbet. Një e drejtë e fituar nuk mund të lihet peng, të ndalohet, transferohet, të ndahet, të lihet hipotekë ose të tjetërsohet në ndonjë mënyrë tjetër. Nuk mund t'i nënshtrohet ekzekutimit, nuk mund të jetë pjesë e ndonjë patundshmërie në falimentim të pjesëmarrësit dhe nuk mund të ndikohet me asnjë procedurë të marrëveshjes dhe çdo përpjekje në këtë drejtim do të jetë e pavlefshme. Kufizimi ndaj tjetërsimit ose ekzekutimit vlen vetëm për të drejtat e fituara që nuk e kalojnë shumën prej njëqindmijë (100.000) euro për pjesëmarrës. Të drejtat e fituara mbi këtë shumë vetëm mund të mbahen ose të tjetërsohen.

Neni 3

Shuma e Kontributeve për Pensionin plotësues pensional

1. Fondet Plotësuese Pensionale, duhet për çdo vit kalendarik përmes akteve normative të brendshme të përcaktojnë shumën e kontributeve si bazë për fitimin e pensionit plotësues.
2. Përcaktimet e shumës së kontributeve si bazë për fitimin e pensionit varen nga kriteret si vijon:
 - 2.1. Shuma nuk duhet të tejkalojë fitimin(et) aktual të pjesëmarrësit, që është subjekt i indeksimit (treguesit) të aplikueshëm në skemën e pensionit të shumave të caktuara;

- 2.2. Shuma e përcaktuar sipas kushteve nga paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 i këtij neni, nuk duhet të tejkalojë 24,000 Euro për vit.
3. Kufizimi i kontributeve vjetore, sipas paragrafit 2 të këtij neni, nuk i adresohet vlerës/shumës së përfitimit për pensionet e kursyera të pjesëmarrësit në Fondit Pensional e cila është transferuar si rezultat i shuarjes së fondit pensional ose për vlerën/shumën e transferuar tek fondi i ri pensional.

Neni 4

Parimet e përcaktimit të vlerës së Kontributeve për Pensionin plotësues pensional

1. Përcaktimi i vlerës së Kontributeve për Pensionin plotësues pensional duhet të bëhet sipas parimeve si në vijim:
- 1.1. Fondet pensionale duhet të kërkojnë vetëm shumën e kontributeve që sigurojnë vazhdimësinë e programit të pensionit duke marrë parasysh ndryshimet afat-gjata që mund të ndikojnë në vlerën e pensionit ashtu që të sigurojnë të ardhura të arsyeshme dhe të favorshme për pjesëmarrësit me rastin e pensionimit.
- 1.2. Vlera e kontributeve për programin e pensionit duhet të jetë në shumën që siguron se ato mbeten në gjendje që mundësojnë pagesën e pensionit për pjesëmarrësit.
- 1.3. Kontributet pensionale duhet të përdoren vetëm me qëllim të sigurimit/ofrimit të mjeteve pensionale. Kontributet pensionale nuk mund shfrytëzohen për të shërbyer për investimet e lira ose qëllime tjera spekulative të individëve.
- 1.4. Paanësia dhe drejtësia në pagesën e benefiteve të pensionit për pjesëmarrësit.

Neni 5

Shuma maksimale e kontributeve

1. Kontributi maksimal për pjesëmarrësin në Pensionin Plotësues Punëdhënës (Fondi i Pensionit) për çdo vit, duhet të jetë në pajtim me të gjitha kërkesat si vijojnë:
- 1.1. Kontributi total vjetor për pjesëmarrësin në pensionin me shuma të caktuara nuk duhet të tejkalojë (3) herë shkallën e rritjes për vit të kohës së shërbimit të bazës së fitimit të pensionit të pjesëmarrësit .
- 1.2. Kontributi total vjetor i pjesëmarrësit në pensionin me shuma të caktuara nuk duhet të tejkalojë 30% të bazës së fitimeve të pensionit të pjesëmarrësit, respektivisht nuk duhet të tejkalojë 20% të bazës së fitimeve të pensionit të pjesëmarrësit, nëse pjesëmarrësi gjithashtu merr pjesë në pensionet e kursimit (pension të detyrueshëm 5%+5% dhe pension plotësues pensional 20%).
- 1.3. Nëse edhe Punëdhënësi dhe pjesëmarrësi kontribuojnë në pensionin me shuma të caktuara, kontributi i pjesëmarrësit nuk duhet të jetë më i lartë se kontributi i Punëdhënësit.
2. Çdo Ofrues i Pensionit duhet ti sigurojë pjesëmarrësit individual një program të pensionit që është i përshtatshëm për pjesëmarrësit duke pasur parasysh fitimet e asaj/atij si dhe nivelin e tolerancës së rrezikut. Ofruesi i Pensionit duhet të shpallë në mënyrë të qartë

të drejtat dhe obligimet për pjesëmarrësit e pensionit që janë të mjaftueshme për pjesëmarrësin që të vendosë për lidhjen apo jo të kontratës për krijimin e fondit plotësues (individual) pensional.

3. Ofruesit e Pensionit që ofrojnë skemën me kontribut të përcaktuar duhet të sigurojnë mundësinë e pjesëmarrësit që të pezullojë, reduktojë, ose të ndalojë kontributet e tij, dhe varësisht prej të drejtave të tij të ngarkojë me tarifa të arsyeshme vetëm nëse:
 - 3.1. Natyra dhe vlera e tarifave të tilla janë përcaktuar dhe përshkruar në detaje në Rregullat e Pensionit, dhe
 - 3.2. Nëse tarifat e tilla u janë shpalosur pjesëmarrësve në kohën e lidhjes së kontratës për krijimin e fondit plotësues (individual) pensional; dhe
 - 3.3. Ofruesi i Pensionit duhet të njoftojë pjesëmarrësit me shkrim për natyrën dhe vlerën e tarifave para se ti ngarkoj me tarifa. Në rast të ndërprerjes së kontributeve njoftimi duhet të përfshijë përshkrimin e të drejtave të pjesëmarrësit për pensionin e shtyrë ose opsionet e transferit.
4. Administrata Tatimore mund të përshkruaj, kohë pas kohe, limitet e vlerës maksimale të kontributeve të pensioneve që do të favorizohen me shtyrje të tatimeve dhe mjeteve tjera fiskale.

Neni 6

Zbatimi dhe Masat Përmirësuese

Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregullore do të jenë subjekt i masave të parashikuara me Ligjin për Fondet Pensionale.

Neni 7

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje do të shfuqizohet Rregulla 16 mbi Vlerën e Kontributeve Pensionale.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci